

## Akti i Themelimit

### "ZGA"

#### Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, më datë 30/01/2024 i nënshkruari:

- **Z. Klaudio Zoga, i biri i Edmond-it, lindur më 28/08/1991, banues në rrugën Rramazan Gashi, pallati 8, banesa 12, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J10828060J.**

Me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (Ligji i Shoqërive) kam vendosur të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "ZGA" (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

#### Emri dhe forma ligjore

##### Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë "ZGA" ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (Ligji i Shoqërive)

#### Selia dhe kohe zgjatja

##### Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Kompleksi rezidencial "Magnet", Pallati Lura, rruga Ndre Mjeda, Godina DB 07 Njesi, nr. 1017 Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm

#### Objekti i veprimtarisë

##### Neni 3.

- 3.1 Shoqëria do të ketë si objekt kryesor:

**Import-eksport dhe tregtimin me shumice e pakice të materialeve industriale, sidomos të veshjeve, kepuceve, konfeksioneve, produkteve të kozmetikës,**



materialeve sportive, te ndertimit, lende te para per industrine ushqimore, material eklektrike, elektronike, hidrosanitare, bimeve mjekesore, pjeseve te kembimit per automjete dhe makineri prodhimi, pijeve freskuese dhe alkoolike, duhanit dhe cigareve, karburanteve dhe vajrave, tregtimin tyre me pakice. Importin dhe tregtimin e pajisjeve dhe aparaturave qe sherbejne per mbikqyrjen dhe ruajtjen fizike te prones dhe individit.


Sherbime ne fushen e sistemeve te teknologjise se informacionit dhe komunikacionit, shitblerje pajisje kompjuterike dhe software, zhvillim software, sherbime transmetimi dhe perpunim te dhenash, trajnime dhe kurse kualifikimi. Importim, eksportim dhe tregtim te sistemeve te teknologjise se informacionit per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve si: software, hardware, networking dhe te gjitha pjeseve periferikeve te tyre.

Disenjim software - Ketu perfshihet projektimi i arkitektures dhe projektimi i detajuar i sistemit software si dhe analiza e kerkesave te sistemit software. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit. Ketu perfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja ne pune dhe mirembajtja e sistemeve te komunikimit te rrjeteve te pajisjeve informatike (LAN/WAN/WLAN/CAN/SAN/MAN).

Importin dhe tregtimin e materialeve per perdorim mjekesor si dhe pajisjeve dhe aparaturave per te njejtin qellim. Importimin dhe tregtimin e linjave teknologjike per industrine ushqimore, te perpunimit te materialeve drusoredhe ato te hidrokarbureve, te perpunimit te lekures dhe veshmbathjeve, te aparaturavene fushen e shendetit dhe trajtimit te medikamenteve mjekesore. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit.

Aktivitet ne fushen e turizmit hapje hotelesh, bar kafe, restorante etj .Sherbime ne fushen publike, sherbim te ndryshme komunale publike, riparim objektesh publike dhe sherbime menaxhimi te tjera ne fushen e sherbimeve publike. Tregti me shumice dhe pakice mobilje, artikuj shtepiake, aparate radio dhe televizoresh dhe aparate te tjera per prodhimin viziv si dhe materialeve te tjera elektrike ne pergjithesi. Ndertim ne pergjithesi, si dhe cdo aktivitet tjeter qe ka lidhje sa me siper dhe te lejuar nga ligji.

Sherbime te inspektimeve dheurvejimeve n/ujore, matje te ndryshme te thjeshta dhe ultrasonike n/ujore Si dhe riparime te objekteve te ndryshme n/ujore. Sherbime te ndryshme trajnimi, ndermjetesimi dhe anketimi. Import, eksport dhe tregtimin me shumice dhe pakice te artikujve, pajisjeve dhe materialeve hidraulike, elektrike, veglave dhe pajisjeve te punes, vula tendryshme perfshi edhe ato te sigurise plumbce dhe shirita sigurie per pajisjet matese dhe jo vetem, pjese nderrimi per pajisje dhe vegla te ndryshme, lende te pare per riparime, ndertime dhe prodhime te ndryshme industriale, pajisje per ofcina dhe servise elektromekanike dhe automekanike, pajisje dhe materiale te ndryshme per sigurimin e energjise elektrike, materiale



mekanike, bojra te gjitha llojeve, materiale te sigurise dhe sinjalistikes rrugore dhe ujore, material kancelarike etj.

Tregetimin e pajisjeve dhe materialeve te ndryshme te sigurise personale dhe kolektive. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e shoqerise apo te treteve. Shoqeria mund te beje te gjitha operacionet tregtare, industriale, te pasurive te luajtshme dhe te pasurive te paluajtshme, financiare dhe te kredise pa kufizim shume, te nevojshme apo te dobishme per arritjen e objektit te shoqerise, apo qe sidoqoft ka ngjashmeri me qellimin e shoqerise.

Shoqeria mund te marre kuota apo pjesemarrje ne shoqeri te tjera me objekt te ngjashem. Te marri financime nga institute te ndryshme kredie, edhe nga shoqeri te tjera apo private, duke dhene garancite e nevojshme imobiliare, reale dhe personale. Import, eksport dhe tregetimin e me shumice dhe pakice te kondicionereve, materialeve promocionale, artikujve dhe materialeve sportive, pajisjeve per palestra, perdeve dhe grilave te te gjitha llojeve, pajisjeve dhe makinerive bujqesore, automjeteve dhe pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e automjeteve, artikujve te kancelarise, detergjenteve dhe materialeve te pastrimit, materialeve dhe pajisjeve stomatologjike, materialeve te ndertimit, pajisjeve dhe eneve te kuzhines, etj.

3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë Akt.

### Kapitali Themeltar

#### **Neni 4.**

4.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë, i përbërë nga 10000 kuota, me një vlerë nominale 10.000 (Dhjetë mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit.

4.2. Ortaku i vetëm themelues:

- Z. Klaudio Zoga, i biri i Edmond-it, lindur më 28/08/1991, banues në rrugën Rramazan Gaxheri, pallati 8, banesa 12, Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër J10828060J, zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.


#### **Neni 6.**

### Organet drejtuese dhe Administrimi

#### **Neni 5.**

5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:

5.2. • Asambleja e Përgjithshme e ortakëve



- Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: z. **Klaudio Zoga** i cili e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejte rinovimi.

**Dispozita Përfundimtare**

**Neni 6.**

- 6.1 Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i vetem i Shoqërisë, sot më datë 30/01/2024 gjuhën shqipe në dy kopje.

**ORTAKU THEMELUES**  
**Klaudio ZOGA**

*Klaudio Zoga*

